



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.4934/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Drita Rexhaj, kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.G nga fshati ... – Komuna e Skenderajit, përfaqësuar nga RR.K, avokat në Prishtinë, rr. "..., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S...", me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga K.P, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës të së paditurës e paraqitur, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.193/2014, i datës 22.10.2018, në seancën jo publike të mbajtur me datë 16.02.2021, mori këtë:

AKTGJYKIM

I.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "S...", me seli në Prishtinë, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.193/2014, i datës 22.10.2018, në pikën I (një) dhe II (dy) të dispozitivit, VËRTETOHET.

II. Aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.193/2014, i datës 22.10.2018, në pikën III (tre) të dispozitivit mbetet i pashqyrtuar.

Arsyetim

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.193/2014, i datës 22.10.2018, me pikën I (një) të dispozitivit pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses L.G nga fshati ... – Komuna e Skenderajit si të bazuar dhe ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve "S..." në Prishtinë, që paditëses në emër të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të dt.29.11.2013, në orën 19:15 në fshatin ...- Komuna Glllogoc ti kompensoj: a) Dëmin jo material dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike – trupore shumë prej 1800 euro, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 1700 euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 7% shumë prej 2.500 euro, në emër të shëmtimit trupor të shkallës së mesme shumë prej 2000 euro, dhe b) Dëmin material, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumë prej 100 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 100 euro. Në pikën II ka detyruar të paditurën që shumat e gjykuara si në alinenë 1 pikën a dhe b të dispozitivit, të ja paguajë paditëses me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga data 21.09.2018, kur është dhënë mendimi nga ekspertët e mjekësisë e gjerë te pagesa definitive, si dhe ka detyruar që në emër të shpenzimeve të procedurës ti paguajë paditëses shumë prej 861.60 euro, të gjitha këto detyrime në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktvendimit, nën kërcenim të përbarimit ligjor, mirëpo në pjesën tjetër të kërkesëpadisë për shpenzimet e procedurës në shumë prej 627 euro e ka refuzuar si të pa bazuar. Ndërsa në pikën III e ka refuzuar si të pa bazë, pjesën e kërkesëpadisë e cila ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material më të lartë se

sa shuma e gjykuar (e aprovuar) si në alinenë I të dispozitivit dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike – trupore, shumën prej 1200 euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1300 euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 2500 euro, në emër të shëmtimit trupor të shkallës së mesme shumën prej 3000 euro.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim bërë Gjykatës së Apelit, të aprovohet ankesa e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet pjesërisht duke vërtetuar – gjykuar shumën prej 4000 euro, ndërkaq për pjesën tjetër të aprovuar mbi këtë lartësi ta refuzoj si të pa bazuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditëses, duke i propozuar Gjykatës ankimore, që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i goditur të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja L.G, nga fshati ... - Komuna e Skenderajit, përmes të autorizuarit të tij me datë 28.05.2014, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 15.200 euro (e *precizuar sikur në parashtrësë*), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses pas shqyrtimit dhe administrimit të provave nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.193/2014, i datës 22.10.2018, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se, nga aktgjykimi penal P.nr 431/2016 i datës 28.12.201, vërtetohet se i pandehuri V.SH.H, është shpallur fajtor për veprën penale “Rrezikim i trafikut publik”, sepse me datën 29.11.2015 rreth orës 19:15 minuta derisa ishte duke drejtuar automjetin e markës “Opell” pronë e SH.H, në rrugën magjistrale Glllogoc- Skenderaj, duke mos përshtatur kushteve të rrugës del nga rruga dhe ndeshet me mbrojtëset anësore të rrugës, me ç’rast i shkakton lëndime trupore vetes dhe bashkudhëtares së tij, këtu paditëses L.G. Në bazë të konstatimit të ekspertëve mjekësor, të dhënë në seancë gjatë shqyrtimit kryesor, është vërtetuar se paditësja nga ky aksident ka pësuar lëndime të cilat janë konsideruar si lëndime të rënda trupore prej të cilave lëndime e njëjta ka pësuar dhimbje të intensitetit të rëndë prej 2 ditëve, të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 7 ditëve, dhimbje të intensitetit të ulët kronike, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 7 %, shëmtim trupor të shkallës së mesme, ndërsa ushqim të përforcuar dhe ndihmë të personit të tretë ka pasur nevojë në kohëzgjatje prej 2 javëve. Po ashtu frikë primare ka pasur në kohëzgjatje prej disa sekonda, frikës sekondare të intensitetit të lartë prej 5 ditëve, të mesëm prej 30 ditëve dhe ajo e intensitetit të ulët vazhdon të jetë prezentë edhe sot kohë pas kohe, vërtetuar nga mendimi i ekspertit A.K - neurokirurg dhe G.H neuropsikiatër. Gjykata kësaj ekspertize ja falë besimin e plotë të cilën e vlerësoj si të punuar mire si dhe të arsyetuar në mënyrë shkencore dhe profesionale. Duke pas parasysht këto konstatime dhe duke u bazuar në nenin 183 të LMD –së, gjykata i gjykoj shumat sikur në dispozitiv të aktgjykimit, të cilat shuma ka vlerësuar se do të shërbejnë si satisfakcion

për dhimbjet e përjetuara dhe frikën, po ashtu do të ndikojnë në rrënjën e baraspeshës psikike dhe emocionale tek paditësja. Sa i përket shëmtimit trupor u mbështet në dispozitën nga neni 323 i LMD –së. Për pjesën refuzuese të aktgjykimit vlerësoj se shumat mbi këto të gjykuara do të ishin të larta dhe jo në përputhje me dëmin e pësuar. Për kamatën vendosi konform nenit 382 të LMD- së, Ka shtuar se përgjegjësia e të paditurës parashihet me Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia dhe dispozitat nga Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, respektivisht dispozitat nga neni 136,140,159,169,179 dhe 183 të tij. Për shpenzimet procedurale vendosi duke u mbështetur në nenin 451 par 1, 452 par 1 dhe 449 par 1 dhe 2 të LPK-së, si dhe sipas TOA –së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale, për të cilat shkelje Gjykata e Apelit çdoherë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK. Aktgjykimi i ankimuar po ashtu del te mos jetë përfshirë as ne shkelje tjera sipas pretendimeve te palës ankuese.

Te pathemeltë gjykata e shkallës së dytë e vlerëson pretendimin ankimor të palës ankuese për shkelje thelbësore te dispozitave te procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadsisë.

Nuk qëndrojnë pretendimet për gjendjen faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes përveç atyre që kanë qenë jo kontestuese janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Baza juridike e kërkesëpadsisë nuk ka qenë kontestuese prandaj me të drejtë gjykata e shkallë së parë është fokusuar në konstatimin e lartësisë së kërkesëpadsisë.

Kjo pasi që lartësia e kërkesëpadsisë sa i përket dëmit jo material dhe material të cilin e kishte pësuar paditësja në aksidentin e ndodhur, e cila ka qenë kontestuese në mes ndërgjygjësve gjatë shqyrtimit kryesor del te jetë vërtetuar përmes nxjerrjes se provës me ekspertim mjekësor të dhënë nga ekspertët Dr. A.K neurokirurg dhe Dr. G.H - neuropsikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesionale kanë konstatuar natyrën e lëndimeve trupore te cilat i kishte pësuar paditësja, mënyrën e manifestimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike trupore dhe frikës se përjetuar, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shkallën e shëmtimit, të cilin e kishte pësuar paditësja si shkak i lëndimeve trupore te marra, mendimit të te cilëve ekspert, besimin e plotë ia fali edhe Gjykata e Apelit, pasi që vlerëson se mendimi i tyre ka qenë i qartë, i plotë, duke përfshirë edhe arsye të mjaftueshme për vërtetimin e fakteve vendimtare sipas çështjes kontestimore ne fjalë.

Sa i përket të drejtës materiale lidhur me përgjegjësinë e të paditurës që e njëjta të kompensojë paditësin lidhur më dëmin e kërkuar, sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, pasi qe e paditura nga baza e auto përgjegjësisë për të siguruarin e saj, me fajin dhe lëshimet e të cilit ishte shkaktuar aksidenti i komunikacionit me datën 29.11.2015 në Gillogoc, nga i cili aksident lëndime te rënda trupore kishte pësuar paditësja, është përgjegjës për kompensimin e dëmit palës paditëse sipas dispozitës së nenit 136,140,159,169,179 dhe 183 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve (LMD), e lidhur me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia.

Te pathemelta Gjykata e Apelit i vlerëson pretendimet ankimore te palës ankuese për shkelje të ligjit material, sa i përket shumave te gjykuara paditëses në emër te dëmit jo material dhe material, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë për dëmin jo material të gjykuar paditëses në emër të dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit trupor, del se ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes shumave të gjykuara dhe këtij lloji dëmit të pësuar, pasi që me rastin e vendosjes ka marrë për bazë të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim në përcaktimin e lartësisë së dëmit, siç janë natyra e lëndimit trupor të pësuar nga paditësi, mënyra e manifestimit, intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike dhe frikës se pësuar, mosha e paditëses në kohën e aksidentit, rrethanat nga aksidenti i ndodhur, praktika e mirë gjyqësore etj, duke siguruar kështu që kompensimi i gjykuar ne pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë për këtë lloji dëmi jo material, të jetë satisfaksion për paditësen dhe duke i shmangur qëllimet tjera materiale, që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Gjykata ankimore nuk i ka pranuar si të themelta pretendimet ankimore ku i referohet zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, në pjesën e gjykuar sa i përket shëmtimit trupor, përkatësisht zbatimit të vlerësimit të lirë, konform nenit 323 të LPK – së. Kjo Gjykatë e ka vlerësuar si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi që ajo me rastin e aplikimit të kësaj dispozite, fillimisht ka vërtetuar elementet thelbësore prej të cilave varet lartësia e këtij dëmi jo material, ku si pikë referimi është marr ekspertiza mjekësore nga Dr. A.K, e cila ka konstatuar shkallën e shëmtimit tek paditësja, pasojat dhe faktin se e njëjta ka nevojë për ndërhyrje kirurgjike – plastike në zonën e fytyrës, si dhe po ashtu ekziston rreziku se edhe pas ndërhyrjes, vrugat apo shenjat do të vazhdojnë të jenë prezente. Andaj duke marr për bazë këto fakte, Gjykata e Apelit vlerëson se kjo shumë e gjykuar për këtë kategori të dëmit jo material është satisfaksion për këtu paditësen dhe do ti mundëson sado pak ti harron përjetimet e pa këndshme të cilat i ka fituar me rastin e këtij aksidenti.

Drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur edhe sa i përket dëmit material te gjykuar paditëses në emër ushqimit të përforcuar dhe ndihmës së personit të tretë, ngase në bazë të mendimit profesional i dhënë nga eksperti, është konstatuar se paditësi si shkak i lëndimeve trupore të pësuar në aksidentin e ndodhur ka pasur nevojë për ndihmë te personit të tretë dhe ushqim te përforcuar në kohëzgjatje prej 14 ditësh, ku nën rrethanën e tillë kjo ka rezultuar me humbje materiale të paditëses pa marrë parasysh faktin se përkuqdesjen ndaj saj ka mundur ta ushtron ndonjë familjar apo edhe person tjetër jashtë familjes se tij, i cili më kompensim është angazhuar qe të përkuqdeset për paditësen gjatë periudhës sa i njëjti ka pas nevojë për ndihmë te personit te tretë.

Përkundër asaj se paditësja për këto dy kategori të dëmit material nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, Gjykata e Apelit duke u nisur nga praktika e gjertanishme e Gjykatave të Kosovës në bazë të së cilës është konstatuar se ne shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë qe te sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi qe kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshin ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, ka gjetur se në rastin konkret paditësit ligjërish i takon ky lloji dëmi në shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, pasi qe edhe më vet kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për Gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kriteret orientuese, rezulton se censorët e tyre në rastet e aksidenteve të komunikacioneve të dëmtuarve jua njohin deri ne 100 euro në muaj për ushqim të përforcuar dhe 100 euro në muaj për kujdes nga personi i tretë.

Gjykata e shkallës së dytë, e vërtetoi edhe vendimin mbi kamatën, edhe për kundër faktit që marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 19.12.2012 shkalla/lartësia e

kamatëvonesës caktohet në lartësi prej 8 %, për dëmin material nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, ndërsa për atë jo material nga dita e marrjes së aktgjyqimit, mirëpo bazuar në nenin 203 të LPK-së, ku është përcaktuar se: “Gjykata e shkallës së dytë nuk mund ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë në dëm të palës ankuese, po që se vetëm ajo ka bërë ankim, e jo edhe pala kundërshtarë”, përkundër gjetjeve të lartcekura, në rastin konkret kjo Gjykatë nuk mund të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar në këtë pjesë, pasi që sipas dispozitës së lartcekur si dhe institutit juridik *reformatio in peius*, pala ankuese nuk mund të vihet në pozitë me të keqe juridike me vendimin e gjykatës së shkallës së dytë, sesa ishte vënë më vendim të gjykatës së shkallës së parë, pra i njëjti aktgjykim nuk mund të ndryshohet në disfavor të palës ankuese, pasi që ankesë nuk ka paraqitur edhe pala paditëse. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e të autorizuarit të paditurës si e pathemeltë.

Aktgjykimi i ankimuar në pikën III (tre) të dispozitivit , e cila i referohet pjesës së refuzuar të kërkesëpadiës nga gjykata e shkallës së parë, nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit pasi që kjo pikë nuk është goditur nga pala e paditur përmes ankesës të cilën e ka ushtruar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpengimeve dhe në pajtim me dispozita të LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4934/18 datë 16.02.2021

Kryetare e Kolegjit- Gjyqtarja
Drita Rexhaj d.v